

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kriza në Kosovë, analistja: Refuzimi për zgjedhjen e nënkryetarëve, pretekst! Vetëvendosja kërkon të zgjasë ngërçin – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/kriza-ne-kosove-analistja-refuzimi-per-zgjedhjen-e-nenkryetare-ve-pretekst-vetevendosja-kerkon-te-zgjase-ngercin/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 19:03:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 18:57:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	26614c3bc94db78228b42c6579692161c07a8d7110d47328fcf216552adb3818
TEKSTI	9335d1c17242f44bf75b642fefdb46fe0e1d63b38c4d2f229a62986fd41b08e5
PAMJA	edd591ebed6d1748e9b9dd047a0b1927e5d586e13217a7bfcf0f486132988d7c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	92a70fffd439a5cf9e07592307778ef73236e3f58422b7c1bcf29f0afed05264
E MËPARSHMJA	f9a3ecc4d8d4c6a500969cbe9e83ffd4e33feb042f86a1e341cb90a2f996d7
RRËNJJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/92a70fffd439a5cf9e07592307778ef73236e3f58422b7c1bcf29f0afed05264>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Kriza politike në Kosovë vijon të mbetet e pazgjidhur, pavarësisht zgjedhjes së kryetares së Kuvendit, Albulena Haxhiu. Mungesa e marrëveshjes për nënkryetarët ka penguar konstituimin e plotë të Kuvendit dhe e ka lënë vendin ende larg formimit të qeverisë së re.

Analistja Alma Lama, në një lidhje të drejtpërdrejtë në edicionin qendror të lajmeve në televizionin kombëtar Vizion Plus me moderator Aleksandër Furxhi, e cilësoi situatën si një krizë të orkestruar. Lama u shpreh se refuzimi për zgjedhjen e nënkryetarëve është një “pretekst” për të zgjatur ngërçin politik.

Sipas saj, afatet kushtetuese kanë kaluar dhe çështja duhet të adresohet urgjentisht në Gjykatën Kushtetuese.

INTERVISTA E PLOTË:

Përse nuk u arrit kompromis, çfarë nuk eci për zgjedhjen e nënkryetarëve të parlamentit?

Alma Lama: Po sot nuk ishte nevoja fare për asnjë lloj kompromisi, për shkak se së pari për zgjedhjen e kryetares Vetëvendosja i kishte votat, nuk kishte negociata të tjera politike. Ndërsa nënkryetarët janë pozita kushtetuese që u takojnë subjekteve politike që marrin më së shumti vota në zgjedhje dhe ato zakonisht votohen në pako. Pra, partitë politike shqiptare, nënkryetarët e tyre votohen veç. Kjo ka qenë praktika parlamentare, ndërsa ato të minoriteteve veç. Lëvizja Vetëvendosje e përdori mekanizmin e votës për ta bllokuar sërish konstituimin e

5 Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor:
Një vit të mbarë për nxënësit,...

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

parlamentit, sepse kjo eshte axhenda e tyre politike. Nuk ka pasur asnje lloj arsyeje tjetër për të mos e bërë këtë.

Kjo është një pretekst apo një çështje thelbësore?

Alma Lama: Jo, nuk është aspak thelbësore. Kjo është tërësisht pretekst. Po, është pretekst për të mos konstituuar parlamentin. Është vetëm një pretekst sepse këto pozita u takojnë partive politike dhe në praktikën parlamentare e në bazë të rregullores votohen të tre së bashku. Pra, përfaqësuesi i Vetëvendosjes, i PDK-së dhe i LDK-së në këtë rast, nënkryetarët votohen në pako. Është një votim krejtësisht formal, gjithmonë ka qenë formal. Ka mundur të mos ketë fare votim sepse këto pozita u takojnë me Kushtetutë. Për shembull, është pak a shumë e ngjashme me kryetarin e grupit parlamentar i cili nuk votohet në Kuvend. Pra, secili subjekt ka të drejtë të dërgojë atë që do ta përfaqësojë në Kryesinë e Kuvendit.

Dhe përpjekja e radhës do të jetë të premten pas dy ditësh. Ne në këto kushte kemi vetëm zgjedhjen e kryetarit të parlamentit, por nuk është konstituuar Kuvendi i Kosovës. Jemi larg ende krijimit të qeverisë dhe akoma më larg zgjedhjes së presidentit të Kosovës. Që do të thotë se mbetet ende mjaft serioze kriza në Kosovë, apo jo?

Alma Lama: Pa diskutim. Nuk pres që edhe të premten të zgjidhet, domethënë të bëhet konstituimi i parlamentit, që Lëvizja Vetëvendosje të votojë, për shkak se qëllimi i tyre është të fitojnë sa më shumë kohë. Duhet thënë edhe një gjë, afatet kushtetuese kanë kaluar më 7 gusht dhe Kosova është tërësisht në shkelje të Kushtetutës. Parlamenti është jolegjitim. Kjo çështje duhet të adresohet urgjentisht në Gjykatën Kushtetuese. Edhe vendimi i sotëm, pra votimi i kryetarit mendoj që duhet të adresohet atje, sepse po rrezikojmë që parlamenti të marrë vendime të paligjshme të njëpasnjëshme pasi afatet kushtetuese kanë kaluar. Mendoj që është krizë tërësisht e orkestruar nga Lëvizja Vetëvendosje. Kërkon të provokojë zgjedhje të tjera për të marrë një numër më të madh deputetësh dhe kërkon që pak a shumë data të bëhet gjatë kohës kur vjen diaspora. Pra është lojë e njëjtë me pretekste të ndryshme. Sot u zu pretekst edhe nga fjala e një deputeti përfaqësues të Listës Serbe që foli në emër të atyre që përfaqëson, që janë qytetarët serbë. Përdori termin 'populli serb', por nuk është në të drejtën e kryetares që t'i diktojë deputetët për mënyrën se si flasin, vetëm në rast se bëjnë shkelje të rënda.

[/vizionplus.tv](#)

#AlmaLama

#Kosova

#kriza

#VizionPlus



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

[Të gjithë artikujt](#)

Vazhdo të lexosh



Zhuleku

17:49

Zhuleku

15:26

Zhuleku

13:37



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.